



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.116/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Milena Gjeriq, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit: Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit: N.T.P., "...", me NUI:..., me seli në F. K., rruga "...", ..., për shkak të përmbarimit të gjobës sipas aktvendimit, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.03.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për gjykim në çështjen juridike - përmbarimore të kreditorit: Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit: N.T.P., "...", me NUI:..., me seli në F. K., rruga "...", ..., kompetente lëndore është Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin E.nr.1593/11 të datës 15.02.2023, ka vendosur: I. Gjykata Themelore në Prishtinë shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për procedimin e kësaj çështje juridike. II. Pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, lënda i dërgohet në kompetencë Gjykatës Komerciale, në Prishtinë.

Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.1845/23 të datës 29.01.2024, ka vendosur: I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Dogana e Kosovës, dhe debitorit N.T.P., "...". II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në bazë të nenit 25 paragraf 2 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr.06/L-054 i datës 23.11.2018, konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit

të ndryshëm e zgjidhë Gjykata Supreme e Kosovës. Në këtë rast Gjykata e Supreme e Kosovës, si gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt ka kompetencë lidhur me zgjidhjen e konfliktit të kompetencës, ndërsa në bazë të nenit 15 paragraf 3, të LPK-së, përcaktohet se: “ Zgjidhjen e konfliktit për kompetencë territoriale dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë e cakton trupë gjykues prej tre gjykatësve ”.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë, gjeti se kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë, për arsye se:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: “ 1. Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbartimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbartimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër. 3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në përmbartimin në anije dhe në mjet fluturues përveç nëse kjo çështje rregullohet me ligj të veçantë. 4. Ky ligj rregullon edhe kryerjen e veprimtarisë së përmbartuesve privat ”.

Me nenin 12 paragraf 1 të Ligjit për Gjykatat me nr. 06/L-054 i datës 23.11.2018, përcaktohet se: “ Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe ”.

Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: “ Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë, për faktin se me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cituara më lart ka konstatuar se çështja për gjykim, kualifikohet si çështje tregtare për arsye se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, kontestet ndërmjet shoqërive tregtare mbi bazën e afarizmit ose përmbartimit të vendimeve lidhur me afarizmin dhe kontestet ndërmjet personave juridik dhe privat në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe

çështjet tjera midis tyre, si dhe të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.

Në këtë rast pala kreditore ka kërkuar pagesën e borxhit, në bazë të titullit përmbare - aktvendimit Nr.08/562 të datës 05.11.2010, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Sipas propozimit të kreditorit për përmbare, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin E.nr.1593/11, të datës 13.02.2020, e ka caktuar përmbare, ndërsa debitori më datë 25.02.2020, ka paraqitur prapësim kundër aktvendimit të lartcekur, e që rrjedhimisht Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me të drejtë është shpallur jokompetente për të gjykuar në këtë çështje, sepse kemi të bëjmë me çështje të ndërsjella tregtare dhe me ushtrimin e mjetit juridik, e duke pas parasysh faktin se Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë, vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit të përmbare siç janë (prapsim apo ankesë) dhe në rastin konkret debitori ka paraqitur prapësim, andaj nga kjo rezulton se kompetente për të gjykuar në këtë çështje juridike - përmbare sipas prapësimit të debitorit është Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë.

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 15 paragraf 3, 25 paragrafi 2 i LPK-së, e lidhur me nenin 12 paragraf 1 të Ligjit për Gjykatat me nr. 06/L-054 i datës 23.11.2018, dhe nenin 13 paragraf 1, pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CN.nr.116/2024 datë 07.03.2024

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi